



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

Nr. _____ Prot.

Pogradec, me 11.06.2026

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Rikonstruksion kanali ujitës rezervuari Qafë
Thanë- Buqezë”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Punë ndërtimi për kanale ujitëse-45247111-1

Punë ndërtimi për rezervuarë-45247270-3

VLERA E FONDIT LIMIT: **7,101,571. 98 (shtatë milion e njëqind e një mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e një presje nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa tvsh.**

Argumentimi i fondit limit: Fondi limit është përlllogaritur nga grupi i punes i ngritur me urdher te titullarit te AK dhe na është vënë në dispozicion me anë të procesverbalit te tyre, të cilët kanë përgatitur projektin, preventivin , specifikimet teknike, relacionin teknik si dhe grafikun e punës, për këtë objekt. Gjatë përlllogaritjes së fondit limit grupi i punes ka mbajtur në konsideratë Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në Nr. 285 datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Neni 76 “Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit” ku thuhet se:

1. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe **çmime të tjera zyrtare**, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe

b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe

c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Me qëllim që fondi limit të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe të mos abuzohet në përlllogaritjen e tij, ata janë mbështetur te manuali zyrtar i çmime të ndërtimit siç është VKM Nr.216 , datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të intergruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” në nenin 5 të së cilës thuhet se: *“Të gjitha institucionet shtetërore, që kryejnë programim të fondeve publike nga buxheti i shtetit apo donatorë të huaj, për efekt planifikimi investimesh për ndërtimin e veprave publike, për të përcaktuar vlerën e fondit limit të veprës orientohen dhe u referohen çmimeve të zërave të punimeve të përcaktuar në sistemin e integruar të manualit të çmimeve të ndërtimit.”*

Bazuar në manualin e sipërcituar si dhe në preventivin për objektin në fjalë ka rezultuar që fondi limit të ketë vlerën prej **7,101,571. 98 (shtatë milion e njëqind e një mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e një presje nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa tvsh.**

Më pas, në mbështetje të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, specilistët e fushës së njësisë së prokurimit kanë bërë analizën dhe zbërthimin e preventivit duke hartuar procesverbalin për argumentimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- c. *Formulari i ofertes sipas Shtojce 1;*

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.*

Kerkesat e mesiperme jane detyruese dhe i sherbejne Autoritetit Kontraktor per te krijuar bindjen e tij se operatoret ekonomik pjesemarres ushtrojne veprimtarine e tyre konform kerkesave te legjislacionit ne fuqi, permbushin kriteret ligjore per te marre pjese ne procedura prokurimi si dhe kane shlyer te gjitha detyrimet tatimore dhe ato te energjise elektrike sipas percaktimeve te legjislacionit perkates.

Po ashtu, paraqitja e sigurimit te ofertes eshte detyrim ligjor i percaktuar nga legjislacioni ne fuqi mesipercituar, si nje mjet garancie per AK ne rast te tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave; refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit apo mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimi të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në *Nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, Nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"*, e ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike për realizimin e objektit të prokurimit operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së parashikuar të kontratës.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së, i ndryshuar, si dhe nenin 43 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj dhe është në përpjesëtim të drejtë me fondin limit të procedurës. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në mbështetje të *Ligjit 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë"*, neni 64 *Deklarata Tatimore*; *Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat"*, i ndryshuar, *Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat"*, i ndryshuar, si dhe *kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"*.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": *"Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.*

Gjithashtu bazuar në nenin 43 paragrafin 1 dhe në pikën b) të paragrafit 2 të këtij neni në VKM-ë nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku thuhet se: *"Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare"*

"Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përlogarit të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

2.2.2 Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor të maturuara për vitin 2026 pranë njësive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Shenim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nepermjet plotesimit dhe paraqitjes nga OE të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë Autoritetit Kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, ose nëse do të jete nevoja për t'u kerkuar sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar si dhe nenin 43, nenin 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, nëni 3.1/a, b, c dhe nëni 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar.

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për Vitin 2026, në të gjitha vendet atje ku ushtrojnë aktivitetin e tyre, sipas ekstraktit të QKB.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten :

1. Formularin e vleresimit sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me;
2. Kontratë
3. Situacionin përfundimtar;
4. Aktin e kolaudimit;

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten

1. Kontrate;
2. Situacionin përfundimtar;
3. Akt kolaudimi;
4. Fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 30 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës dhe që është realizuar gjatë pesë vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë vjetëve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet. Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: **”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.**

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Lidhur me dokumentacionin e kërkuar për vërtetimin e punëve të ngjashme janë kërkuar keto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 55, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku ndër të tjera përcaktohet se:

Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë:

a) Për kontratat e punëve:

- i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë vjetëve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Kriteret e mëposhtme teknike nga pika 2.3.2 dhe ne fund janë propozuar dhe vendosur nga specialisti i fushës, Inxhinieri i Njesise se Prokurimit, pjesë e struktures qe ka hartuar projekt-preventivin, sipas përcaktimit të nenit 74, dhe 78 të VKM nr. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik“ e ndryshuar, Njoftimit nr. 4916/2 prot, datë 14.07.2022, pika 1, të Agjencisë së Prokurimit Publik “Mbi organizmin e Procedurave të Prokurimit Publik” si dhe Rekomandimit te APP nr. 787 prot, date 23.01.2026, me lende: ”Mbi Hartimin e kriterëve per kualifikim per Procedurat e Prokurimit per Mallra, Pune, Sherbime”.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet te paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”,te ndryshuar e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

N.P - 1A Punime gërmimi në tokë.

NP – 7A Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjise, (ose Ministrise kompetente te kohes) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Gjithashtu, të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, Ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, Neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane” si dhe Udhëzimit nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, pika 1.1 ku percaktohet se: çdo subjekt juridik i licencuar ka të drejtë të ushtrojë veprimtari zbatimi, vetëm në klasat dhe kategoritë e punimeve, që ka

përcaktuar në licencë. Kushtet dhe kriteret, që duhet të plotësojë subjekti juridik për të fituar klasa e kategori në zbatimin e punimeve të ndërtimit, përcaktohen në rregulloren për dhënien e licencave profesionale, që miraton Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

<i>Kategoria e kërkuar</i>	<i>Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës</i>	<i>Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>	<i>Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive</i>	<i>Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>
<i>Kategoria NP-1</i>	<i>Punime germimi në tokë</i>	<i>Seksioni 1-Punime germimi</i> Germim kanalesh ne toke te forte, me krahe, me seksion deri 0.75 m ² Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke Rrafshim skarpatesh, me krahe, ne germim toke te zakonshme Mbushje, rafshim,ngjeshje me tokmak elektrik, cdo 30 cm, toke te forte	<i>Niveli A</i>	<i>0-20 milion leke</i> <i>Vlera e parashikuar ne preventiv</i>
<i>Kategoria NP-7</i>	<i>Ujësullës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje.</i>	<i>Seksionet e tjera</i> F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm Struktura monolite betoni C 16/20 Pergatitje konstruksione metalike te thjeshta Mur guri mbajtes e themele, llaç çimento M50 Prerje bime te vogla ø ~ 10cm F.V tuba celiku ■ 400 mm	<i>Niveli A</i>	<i>0-20 milion leke</i> <i>Vlera e parashikuar ne preventiv</i>

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- Inxhinier hidroteknik 1 (një)

i cili, duhet te jetë ne Listëpagesa te pakten për muajin e fundit nga hapja e ofertave si dhe te figurojne në licensën e shoqërise, per te cilin duhet të paraqitet:

- kontratë pune e vlefshme
- -diploma përkatëse.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” te ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te dryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierin në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si inxhinieri hidroteknik , është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të kualifikuar dhe te thjeshte, si më poshtë:

-Teknik Ndërtimi	1 (një)
-Punëtor	7 (shtatë)
-Hidraulik	4 (katër)
-Shofer	1 (një)
-Manovrator	1 (një)

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për muajin e fundit, ndersa per shoferet/ manovratorët kur mjetet disponohen me qera drejtuesit e mjeteve mund te disponohen me kontrate pune, së bashku me mjetet e marra me qera, pa pasur nevojë te jene te perfshire ne listepagesat e operatorit ekonomik ofertues.

Per punonjesit e kualifikuar te paraqitet Certifikatat/diplomat/deshmi te leshuara nga institucione publike /private te licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional ne R.SH“, I ndryshuar.

Per shoferet te paraqitet leje drejtimi e vlefshme. Per manovratorët leje drejtimi e vlefshme dhe deshmi e aftesise profesionale nga DPSHTRR.

Nuk do të njihen si dëshmi profesionale kurset e trajnimit të lëshuara nga subjektet të cilat nuk janë të licensuara/akredituara nga institucionet përkatëse për licensimin/akreditimin e tyre.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Në kriterin mesipercituar është kërkuar që OE të kenë të punësuar teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, sipas fushave që përfshijnë punimet për zbatimin e projektit.

Këtu përfshihen kërkesat për punonjësit, të cilët janë trajnuar/certifikuar për kryerjen e punimeve të caktuara të zbatimit, pasi kanë kryer me sukses kurse dhe trajnime profesionale për punimet respektive. Zbatimi i punimeve që përfshin projekti duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Punëtori i ndërtimit dhe profesionet e lidhura me to ndërtojnë, mirëmbajnë dhe riparojnë strukturat e tjera që nga themelet, muret dhe pjesët e tjera kryesore të skemes ujëtore dhe konstruksione të tjera, si jashtë ashtu edhe brenda duke përdorur teknika dhe materiale tradicionale apo moderne të ndërtimit.

-Për zbatimin e punimeve ndërtimore të tilla si punimet e gërmimit, punimet strukturore, punimet e shtresave, janë kërkuar 1 (dy) teknik ndërtimi Kjo është një kërkesë shumë minimale, duke marrë parasysh vëllimin e madh të punimeve dhe grafikun e punimeve.

-Për realizimin e punimeve hidraulike në objekt janë kërkuar 4 (kater) hidraulik, i cili merret me ndërtime, montime, instalime, riparime dhe mirëmbajtje të sistemit hidraulik, të sistemit të ujitjes, të sistemeve hidraulike të objekte të tjera që përdorin sisteme hidraulike të ngjashme. Ai monton, instalon, riparon dhe mirëmban pajisjet dhe aksesoret për ujë, gaz, kullim, kanalizim, pajisje të sistemeve të ngrohje- ftohjes, pajisje pneumatike etj. Kjo është një kërkesë shumë minimale, duke marrë parasysh vëllimin e punes ne kete objekt prokurimi.

-Për zbatimin e punimeve në objekt janë kërkuar dhe 7 punonjes te cilet jane kane dale nga nje analize e hollesishme e preventivit, projektit dhe grafikut te punes. Ata jane ne perpjestim me objektin, te llogareitur me ore pune dhe te nevojshem per realizimin me sukses te kesaj kontrate.

- AK ka kërkuar nje manovrator per perdorimin e makinerive te rende qe kerkohen per zbatimin me skuses te kontartes.

-Ak ka kërkuar dhe nje shofer ose person me leje drejtimi pasi objekti ka nevojje per nje person te tille qe drejton mjetet qe nevojiten per realizimin e kesaj kontrate.

Percaktimi i numrit te punonjesve dhe profesionet eshte bazuar mbi zerat dhe volumet e punes si dhe afateve per perfundimin e punimeve, ne mbeshtetje te Manualit te ndertimit miratuar me Vendim Nr. 216, datë 13.4.2023. Bazuar ne kater elementet e struktures se kosos(material, puntori, makineri, transport). Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është

përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 13 (trembedhjte) persona për muajin e fundit nga hapja e ofertave, e vertetuar kjo me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit nga hapja e ofertave.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit nga hapja e ofertave.

***Shënim:** Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

Argumentimi: Në përcaktimin e numrit te punonjësve specialistët e fushës kanë bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje prej një muaji të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listëpagesat me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. *Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 13 persona, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet.* Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në katër elementet e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport). Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

Këtë përlllogaritje si nevojë e transparencës ndaj ofertuesve po e paraqesim të detajuar, si më poshte:

8	1.100/p	Pergatitje konstruksione metalike te thjeshta	ton	0.002	80	0.16				
		5. NDERTIMI I VEPRAVE TE ARTIT+KANALIZIME								
9	3.323	Mur guri mbajtes e themele, llaç çimento M50	m3	1.0	9.3	9.3				
		6. PUNIME SHPYLLEZIMI								
10	3.2	Prerje bime te vogla ø ~ 10cm	m2	1575.0	0.08	126				
		7. ANALIZA JASHTE LISTE								
11	Analize	F.V tuba celiku ■ 400 mm	m	20.0	0.3	6	9.86	Kamionci në deri 3.5 ton		1
		Ore pune ne total per kryerjen e punimeve								
		Referuar Normatives sipas Manualit te Ndertimit				4044				
		Dite pune 8 orarshe ne total				505				

		Dite pune mujore (26 dite)				19				
		Periudha ne dite per kryerjen e punimeve eshte 1 muaj e gjysem (45 ditë pune)				13				
		Numri i fuqise punetore per kryerjen e punimeve per 1.5 muaj				13				
		Gjithsej fuqia punetore e nevojshme per realizimin e kontrates				13				

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik
punonjës minimumi: Teknik Ndërtimi 1 (një)
Inxhinier Hidroteknik 1(një)

Punëtorë	7 (shtatë)
Manovrator	1 (një)
Hidraulik	4 (katër)
Drejtues Mjeti	1 (një)

2.3.6 Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në pajisjet/kapacitetet e meposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontrates:

Nr.	Lloji i mjetit	Njesia	Sasia	Statusi
1	Autoveteshkarkuese 7 – 10 ton	Cope	1	Ne pronesi ose me qira
2	Betoniere	Cope	1	Ne pronesi ose me qira
3	Eskavator me goma	Cope	1	Ne pronesi ose me qira
4	Kamioncine deri ne 3.5 ton	Cope	1	Ne pronesi ose me qira
5	Vibrator thellesie	Cope	1	Ne pronesi ose me qira
6	Tokmak Elektrik	Cope	1	Ne pronesi ose me qira

-Ne rast se mjeti eshte ne pronesi te paraqiten: certifikata e pronesise, leja e qarkullimit, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit dhe çertifikatë për transport mallrash brenda vendit, te vlefshme.

-Ne rast se mjeti eshte me qera te paraqiten: kontrata e qerese vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi, e shoqeruar me lejen e qarkullimit ,certifikaten e pronesise, certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit dhe çertifikatë për transport mallrash brenda vendit, te vlefshme.

- Në rastin e mjeteve të tjera duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre si aktet e zhdoganimit/faturat tatimore të blerjes dhe kur ato janë të marra me qera të paraqitet kontrata e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj si edhe dokumentat që vërtetojnë pronësinë e qiradhënënsit si aktet e zhdoganimit/ faturat tatimore të blerjes.

(Ne rastin e mjeteve te marra me qira nga operatorët ekonomike bazuar ne njoftimin e APP nr. 4916/2 prot date 14.07.2022 , referuar dokumentacionit(leje qarkullimi, çertifikate e transportit te mallrave) , mjetet nuk duhet te rezultojne per perdorim vetjak por per perdorim nga te tretet).

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi / qira / kontrate furnizimi janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Gjithashtu për përcaktimin e numrit të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës *bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).*

2.3.8 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

- ISO 9001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) -ose ekuivalent.
- ISO 14001 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit)ose ekuivalent
- ISO 45001:2018 e përditësuar, (SSH EN UNI ISO 45001 – 2023) - ose ekuivalent.

Te gjitha Certifikatat duhet të jenë të vlefshme dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH’.

Në rast Bashkimi të Operatorëve Ekonomikë, secili Operator Ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat e mësipërme sipas natyrës së punimeve që do të marre përsiper të realizojë, referuar kontrates së bashkepunimit të nënshkruar.

Argumentim: *Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas kesaj pike janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma*

ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar , ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 –ose ekuivalent Sikurse vëren edhe VNM e përgatitur nga projektuesi, zbatuesi i punimeve duhet të marrë parasysh një sërë masash për zbutjen e efekteve negative në mjedis, si rezultat i zbatimit të punimeve për përmbushjen e kësaj kontrate. Të gjitha punimet e parashikuara në këtë procedurë duhet të kryhen në përputhje me specifikimet dhe dokumentacionin teknik të përgatitur nga projektuesi, duke respektuar legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e mjedisit.

Nga sa më sipër AK ka kërkuar që OE të paraqesë certifikatën ISO 14001:2015 (ose të përditësuar) për të dëshmuar kapacitetin për të kryer punimet në përputhje me rekomandimet e VNM, në konformitet me legjislacionin mjedisor në fuqi dhe standartet shtetërore dhe ndërkombëtare të menaxhimit mjedisor.

ISO 45001:2018 e përditësuar, (SSH EN UNI ISO 45001 – 2023) është standard ndërkombëtarë, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2023 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

Në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, cilësohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në

përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike, termat e references, raporti teknik, preventivi me zerat e punimeve janë pjese DST.

Argumentimi i specifikimeve teknike :

Specifikimet/Relacioni Teknik/preventivi/projekti dhe grafiku per proceduren respektive jane hartuar nga grupi i punes i ngritur me urdher te titullarit te AK.

Specifikimet Teknike jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive.

Fondi Limit i perlllogaritur per kete procedure eshte hartuar ne baze te VKM nr 216 date 13.04.2023.

Vendosja dhe argumentimi i kriterëve /Hartimi i kërkesave për kualifikim lidhur me kapacitetet teknike për këtë objekt prokurimi është bërë nga grupi i punes, në respektim dhe të parashikimeve të nenit 74/4 të të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

NJËSIA E PROKURIMIT